01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	26,280	108,895	135,175	1,000	0	1,000	136,175	26,280	108,895	135,175	1,000	0	1,000	136,175	26,280	108,395	134,675	1,000	0	1,000	135,675
89	**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**127,470**	**34,230**	**161,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**162,700**	**127,470**	**34,230**	**161,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**162,700**	**127,470**	**35,230**	**162,700**	**1,000**	**0**	**1,000**	**163,700**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	127,470	34,230	161,700	1,000	0	1,000	162,700	127,470	34,230	161,700	1,000	0	1,000	162,700	127,470	35,230	162,700	1,000	0	1,000	163,700
90	**Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik**	**92,398**	**21,000**	**113,398**	**1,000**	**0**	**1,000**	**114,398**	**92,398**	**21,000**	**113,398**	**1,000**	**0**	**1,000**	**114,398**	**92,398**	**19,500**	**111,898**	**1,000**	**0**	**1,000**	**112,898**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	92,398	21,000	113,398	1,000	0	1,000	114,398	92,398	21,000	113,398	1,000	0	1,000	114,398	92,398	19,500	111,898	1,000	0	1,000	112,898
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**60,730**	**13,120**	**73,850**	**1,000**	**0**	**1,000**	**74,850**	**60,730**	**13,620**	**74,350**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,350**	**60,730**	**14,120**	**74,850**	**1,000**	**0**	**1,000**	**75,850**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	60,730	13,120	73,850	1,000	0	1,000	74,850	60,730	13,620	74,350	1,000	0	1,000	75,350	60,730	14,120	74,850	1,000	0	1,000	75,850
92	**Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit**	**41,970**	**16,840**	**58,810**	**1,000**	**0**	**1,000**	**59,810**	**41,970**	**16,840**	**58,810**	**1,000**	**0**	**1,000**	**59,810**	**41,970**	**17,840**	**59,810**	**1,000**	**0**	**1,000**	**60,810**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	41,970	16,840	58,810	1,000	0	1,000	59,810	41,970	16,840	58,810	1,000	0	1,000	59,810	41,970	17,840	59,810	1,000	0	1,000	60,810
95	**Autoriteti për të Drejtën e Informimit nga dosjet e ish-sigurimit**	**132,100**	**27,100**	**159,200**	**2,000**	**0**	**2,000**	**161,200**	**132,100**	**27,100**	**159,200**	**2,000**	**0**	**2,000**	**161,200**	**132,100**	**28,100**	**160,200**	**2,000**	**0**	**2,000**	**162,200**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	132,100	27,100	159,200	2,000	0	2,000	161,200	132,100	27,100	159,200	2,000	0	2,000	161,200	132,100	28,100	160,200	2,000	0	2,000	162,200
	TOTALI	126,833,298	196,732,699	323,565,997	112,466,000	42,212,000	154,678,000	478,243,997	127,118,698	206,282,756	333,401,454	97,812,000	50,300,000	148,112,000	481,513,453	128,018,698	210,565,494	338,584,192	97,221,500	52,797,000	150,018,500	488,602,692

VENDIM
Nr. 120, datë 26.2.2025

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME "QENDËR HISTORIKE" TË NJË ZONE NË FSHATIN RABDISHT, PESHKOPI, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a" e "ç", të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes "iii", të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 53, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Qendër historike" të një zone në fshatin Rabdisht, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të "Qendrës historike" të një zone në fshatin Rabdisht, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të "Qendrës historike" të fshatit Rabdisht dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PLANI
PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS MBROJTËSE TË FSHATIT RABDISHT

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të saj në fshatin Rabdisht, si dhe kufijtë e tyre.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij plani është:

1. Administrimi i "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të fshatit Rabdisht, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë integrale e tij.

2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të "Qendrës historike" të fshatit Rabdisht.

3. Mënyra e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për ruajtjen, mbrojtjen, administrimin dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të "Qendrës historike" të fshatit Rabdisht.

Neni 3
Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Rabdisht përbëhet nga:

a) qendra historike;

b) zona mbrojtëse.

2. Brenda këtyre zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen ansamble arkitektonike-urbane, objekte shoqërore, banesa tradicionale të lidhura ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik, tradicional, zona të gjelbra, sheshe dhe një rrjet rrugor me kalldrëm në pjesën dominuese të tij.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Dibër duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të saj.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse përreth saj.

Neni 4
Qendra historike dhe kufijtë e saj

1. "Qendra historike" e fshatit Rabdisht është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit dhe arritjet në arkitekturë e në urbanistikë. Koordinatat në sistemin referues zyrtar në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) të "Qendrës historike" paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

2. Kufijtë e "Qendrës historike" paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Rabdisht, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 5
Zona mbrojtëse e "Qendrës historike" dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotëson e pasuron vlerat e qendrës historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të lira të fshatit.

2. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Rabdisht, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

Neni 6
Ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike"

1. Ndërhyrjet në "Qendrën historike" kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike të fshatit Rabdisht.

2. Në "Qendrën historike" nuk lejohen ndërtimet e reja.

3. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të "Qendrës historike", brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Ndërhyrje sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese e të bimësisë tradicionale;

c) Ritrajtimi dhe rikonstruksioni pjesor, ku të ruhet maksimalisht objekti ekzistues, duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet e trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve karakteristike dhe ndërtimet e vëna në mbrojtje, duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre (2 kate). Këto ndërhyrje shoqërohen me studime arkitektoniko-urbanistike për evidentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore brenda zonës;

ç) Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me plloça guri. Mbulesat e tjera, si llamarinë, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla janë të ndaluara;

d) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose të djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni/rindërtimi mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;

dh) Ndalohen ndërtimet e reja në "Qendrën historike", me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve, të përmendura në pikat më sipër.

Neni 7
Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike"

1. Në këtë zonë kryhen:

a) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes, përshtatje, rikonstruksione e ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit;

b) rijetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t'i kalojë 3 (tre) katet dhe lartësinë 10 (dhjetë) m deri në kornizën e çatisë.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

4. Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25–30 gradë dhe të mbulohen me plloça guri ose tjegulla vendi ngjyrë gri. Mbulesat e tjera, si llamarinë, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara.

5. Rrjeti rrugor ruhet në kompozimin teknikë dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.

6. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale.

7. Lejohen ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.

8. Lejohen ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës, brenda së cilës rruga ndodhet.

9. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet shtrihet në disa zona, ndërhyrja u nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 8

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të saj

1. Ndalohen ndërtimet e reja në "Qendrën historike", me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

2. Në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike" nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.

3. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda territorit të "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të saj, trajtohen në përputhje me ligjin nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoriteteve të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.

Neni 9

Objektet pa status, pjesë e ansambleve arkitektonike të "Qendrës historike"

Objektet pa status, pjesë e ansambleve arkitektonike të "Qendrës historike", janë objekte të ndërtuara në vitet '50–'90 brenda qendrës historike, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të këtyre ansambleve.

Neni 10

Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike", monumentet e kulturës dhe zonën mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Qendrës historike" të zonës mbrojtëse të saj, të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione dhe rindërtime hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim "IKTK"), drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (në vijim "DRTK"), përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e

miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim "KKTKM").

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e objekteve në "Qendrën historike" hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto projekte hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e miratohen në KKTKM.

3. Projektet për rikonstruksionin / rindërtimin / ritrajtimin/rijetëzimin e objekteve ekzistuese brenda "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik e grafik;

b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;

c) duke ruajtur sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

ç) duke respektuar kushtin që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy-tri kateve;

d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

dh) duket ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja, brenda zonës mbrojtëse të "Qendrës historike", hartohen bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Peshkopi apo studimeve urbanistike e arkitektonike, nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.

5. Projektet për rikonstruksionin e ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore brenda zonës mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen:

a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Peshkopi;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në "Qendrën historike" dhe zonës mbrojtëse

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Qendrës historike" dhe të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione, rindërtime dhe rehabilitimi, hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen në KKTKM.

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rijetëzimin në "Qendrën historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rikonstruksionin / rindërtimin / ritrajtimin e objekteve ekzistuese brenda "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja ose subjekte të

licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për rikonstruksionet, ndërhyrje integruese, përshtatjet në sheshe të lira dhe ndërtimet e reja në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit dhe ndërtimeve të reja kryhen nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi- dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe për zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimit dhe për zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në "Qendrën historike" hartohen nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.

Neni 12
Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.



ANEKSI I

KOORDINATAT E "QENDRËS HISTORIKE" TË NJË ZONE NË FSHATIN RABDISHT

1	541084.9	4616802
2	541098.9	4616799
3	541120.3	4616792
4	541134.9	4616786
5	541146.6	4616786
6	541154.9	4616785
7	541158.6	4616784
8	541163.6	4616781
9	541168.6	4616774
10	541171.1	4616772
11	541249.9	4616785
12	541267.2	4616764
13	541280.2	4616772
14	541286.8	4616766
15	541311.7	4616762
16	541328.7	4616761
17	541336.1	4616762
18	541343	4616763
19	541345.6	4616763
20	541366.3	4616773
21	541370.9	4616774
22	541375.4	4616774
23	541379.6	4616775
24	541382.5	4616776
25	541387.4	4616776
26	541411.6	4616800
27	541425	4616800
28	541465.5	4616787
29	541476	4616716
30	541474.6	4616710
31	541473.2	4616705
32	541471.1	4616702
33	541438	4616713
34	541421.5	4616716
35	541398.6	4616716
36	541384.3	4616712
37	541364.1	4616708
38	541350.9	4616700
39	541338.8	4616672
40	541335.6	4616666
41	541326.4	4616651
42	541313.6	4616631
43	541284.2	4616644
44	541270.9	4616609
45	541248.6	4616615
46	541239.9	4616622
47	541213.1	4616635
48	541209.9	4616631
49	541184.9	4616637
50	541181.8	4616682
51	541183.2	4616685
52	541180	4616698
53	541173.9	4616695

54	541162.8	4616716
55	541158.2	4616722
56	541144.7	4616713
57	541142.1	4616714
58	541130.3	4616728
59	541126	4616737
60	541116.5	4616737
61	541110.5	4616736
62	541102.2	4616762
63	541090.3	4616763
64	541084.8	4616802
65	541084.9	4616802
66	541084.9	4616802

ANEKSI II

ZONA MBROJTËSE E "QENDRËS HISTORIKE" TË NJË ZONE NË FSHATIN RABDISHT

1	540976.922	4616786
2	540988.325	4616766.3
3	540997.347	4616790.62
4	541023.04	4616749.7
5	541030.762	4616791.2
6	541043.465	4616703.44
7	541048.228	4616713.04
8	541051.638	4616847.01
9	541051.638	4616847.01
10	541069.735	4616661.65
11	541089.889	4616838.78
12	541105.316	4616650.47
13	541114.843	4616626.58
14	541125.253	4616840.37
15	541154.754	4616608.75
16	541157.153	4616840.22
17	541177.849	4616539.32
18	541184.867	4616848.16
19	541195.26	4616854.8
20	541205.075	4616855.81
21	541219.78	4616555.27
22	541236.957	4616569.78
23	541248.09	4616876.16
24	541259.782	4616888.29
25	541281.74	4616896.46
26	541292.241	4616584.28
27	541315.083	4616918.69
28	541326.486	4616929.95
29	541337.024	4616933.99
30	541357.087	4616911.04
31	541360.588	4616574.47
32	541367.011	4616623.47
33	541372.821	4616892.28
34	541461.556	4616604.24
35	541464.515	4616929.01
36	541531.13	4616670.56
37	541535.532	4616723.61
38	541538.419	4616671.72

39	541543.182	4616677.78
40	541546.647	4616916.38
41	541552.637	4616796.43
42	541553.936	4616681.17
43	541560.648	4616689.69
44	541561.586	4616864.85
45	541572.196	4616847.39
46	541578.98	4616751.69
47	540976.922	4616786

VENDIM
Nr. 121, datë 26.2.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 845, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TURISTIKE DETARE, QË KRYHEN NËPËRMJET MJETEVE LUNDRUESE PËR QËLLIME TURISTIKE DHE ARGËTIMI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 43/2020, "Për aktivitetet e turizmit detar", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që i bashkëlidhet vendimit nr. 845, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në tekst, fjalët "... i/ licencuar si operator turistik me licencën me kodin XIII.1.B, "Operator turistik", dhe ..." hiqen.

2. Në pikën 1, të kreut I, fjalët "... të licencuar si "Operator turistik", me kodin XIII.1.B dhe ..." hiqen.

3. Në pikën 10, të kreut I, fjalët "... i licencuar me licencën me kodin XIII.1.B si "Operator turistik" dhe ..." hiqen.

4. Në shkronjën "a", të pikës 6, të kreut II, fjalët "... licenca si operator turistik ..." hiqen.

5. Në pikën 1, të kreut VII, fjalët "... licencuar e ..." hiqen.

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 12, datë 24.2.2025

PëR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 22.7.2024, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE ARSIMORË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 22.7.2024, "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 17, të kreut III, bëhet ndryshimi si më poshtë:

"a) Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në profilin përkatës.

Mësuesit që janë përjashtuar nga detyrimi i provimit të shtetit, ngarkojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën

përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe diplomat e kandidatëve që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimit fizik.

Mësuesit nëse kanë, ngarkojnë edhe:

i. Diplomë të ciklit të dytë master me 60–120 kredite, e cila nuk është diplomë që vlen si kriter arsimimi për profesionin e mësuesit;

ii. Diplomë të ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60–120 kredite;

iii. Diplomë për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.

b) Shkronja "b" e shtojcës nr. 5 ndryshon si më poshtë:

"b) Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master me 60-120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë "Master ekzekutiv" ose të barasvlershme me to me 60–120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës.

Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit.

1. Diploma me 60–90 kredite, vlerësohen me 8 pikë.

2. Diploma me 120 kredite, vlerësohen me 9 pikë.

3. Doktoraturë, vlerësohet me 10 pikë."

c) Togfjalëshi në kolonën e pikëzimit, që i përket shkronjës "b" të shtojcës nr. 5, ndryshon "*nga 5–10 pikë"* në "*8–10 pikë"*.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA FRROKU KUNDËR SHQIPËRISË
(*kërkesa nr. 30658/18*)

VENDIM

STRASBURG
4 shkurt 2025

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial

Në çështjen Frroku kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Lətif Hüseynov*, Kryetar*,
Darian Pavli,
Úna Ní Raifeartaigh*, gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 30658/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 20 qershor 2018, nga shtetasi shqiptar z. Arben Frroku (kërkuesi), i lindur në vitin 1969, me adresë të paditur dhe i përfaqësuar nga z. T. Prendi, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën qeverinë e Shqipërisë (qeveria) të përfaqësuar nga Agjentët në atë kohë, z. A. Metani, znj. J. Mansaku dhe më pas nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 14 janar 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë, kryesisht, me shkeljen e pretenduar të të drejtës së kërkuesit për të marrë një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës dhe garanci të tjera për gjykim të drejtë sipas nenit 6.

2. Më 3 prill 2015, Gjykata e Krimeve të Rënda e shpalli kërkuesin të pafajshëm për vrasje dhe armëmbajtje pa leje.

3. Më 29 qershor 2015, Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda (Gjykata e Apelit), e përmbysi atë vendim dhe e gjeti kërkuesin fajtor për të dyja akuzat dhe e dënoi *in absentia* me burgim të përjetshëm.

4. Më 24 korrik 2015, kërkuesi depozitoi një rekurs në Gjykatën e Lartë, me pretendimin që vendimit të Gjykatës së Apelit i mungonte arsyetimi dhe nuk ishte i bazuar në prova, që kërkuesi kishte një alibi në lidhje me vrasjen dhe që prokuroria nuk kishte arritur të provonte praninë e kërkuesit në vendngjarje. Gjithashtu, ai u ankua që nuk ishin marrë parasysh provat që e shfajësonin.

5. Më 8 qershor 2017, Gjykata e Lartë e rrëzoi *de plano* rekursin e kërkuesit me arsyetimin që nuk përmbante ndonjë argument të pranueshëm.

6. Më 10 korrik 2017, kërkuesi depozitoi një ankim kushtetues ku paraqiste pretendimin për mungesën e paanshmërisë nga Gjykata e Lartë për shkak të përfshirjes së mëparshme të disa prej gjyqtarëve të saj në vendimin për masat e sigurimit të marra ndaj kërkuesit; për shkeljen e prezumimit të pafajësisë; për shkeljen e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës për shkak se Gjykata e Lartë nuk kishte zhvilluar një seancë dëgjimore; dhe për mungesën e arsyeve të duhura për vendimin e Gjykatës së Lartë. Më 18 dhjetor 2017, kërkuesi paraqiti ankime të tjera në Gjykatën Kushtetuese, ku kundërshtonte vendimin e Gjykatës së Apelit për mungesën e arsyetimit; për mungesën e paanshmërisë; për shkeljen e së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës; dhe për shkeljen e barazisë së armëve.

7. Më 24 prill 2018, Gjykata Kushtetuese, në trup gjykues me nëntë gjyqtarë, rrëzoi përfundimisht ankimin kushtetues të kërkuesit. Gjykata u shpreh që nevojitej shumica me pesë vota sipas nenit 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili parashikon që: "Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e (*rrëzuar*) përfundimisht.". Arsyetimi i vendimit kishte të bënte jo vetëm me rezultatet e votimit (katër vota kundër dy në favor të rrëzimit të ankimit kushtetues) dhe faktin që gjykata nuk mund të arrinte shumicën prej pesë votash për asnjë nga çështjet e ngritura në ankim. Në shënimin fundor jepet ndarja sipas çdo vote individuale të çdo gjyqtari. Sipas nenit 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ai vendim ishte përfundimtar.

II. PRAKTIKA DHE LEGJISLACIONI PËRKATËS I BRENDSHËM

8. Në çështjen *Marini kundër Shqipërisë* (nr. 3738/02, 18 dhjetor 2007) Gjykata gjeti që rrëzimi i ankimit kushtetues për shkak se gjykata nuk kishte arritur "shumicën e kërkuar të votave për një nga rezultatet" shkelte të drejtën për gjykim të drejtë. Pas atij vendimi, ligji nr. 99/2016, ndryshoi nenin 73(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Sipas këtyre ndryshimeve, nuk është më e mundur që të rrëzohet një ankim individual për shkak të mungesës së pesë votave të shumicës. Në këtë çështje, ankimi rrëzohet përfundimisht.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1, TË NENIT 6 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR NJË VENDIM TË ARSYETUAR NGA GJYKATA KUSHTETUESE

9. Qeveria pretendoi që kërkuesi nuk kishte statusin e viktimës dhe që ankimi i tij ishte abuziv, i pambështetur më tej. Gjithashtu, pretendoi që ankimi i kërkuesit ishte me natyrë të shkallës së katërt dhe prandaj i papranueshëm.

10. Gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë, në lidhje me statusin viktimë të kërkuesit dhe kërkesën si abuzive dhe të pambështetur. Gjithashtu, Gjykata vëren që ankimi i ngritur nga kërkuesi ka të bëjë me një të drejtë të mbrojtur nga Konventa. Prandaj, Gjykata konkludon që nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër dhe prandaj duhet të shpallet i pranueshëm.

11. Parimet e përgjithshme, në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese në kontekstin e rrëzimit të ankimeve kushtetuese për shkak të mos arritjes së shumicës me pesë gjyqtarë, janë përmbledhur në çështjen *Meli dhe Swinkles Family Brewers N. V. kundër Shqipërisë* (nr. 41373/21 dhe 48801/21, §§ 72–75, 16 korrik 2024).

12. Kërkuesi pretendoi që Gjykata Kushtetuese nuk kishte dhënë ndonjë arsyetim në lidhje me ankimet dhe argumentet e paraqitura përpara saj, sepse vendimi që rrëzoi këto ankime përmbante vetëm rezultatet e votimit. Kërkuesi pretendoi që ai nuk ishte në gjendje të kuptonte arsyen e rrëzimit të ankimeve të tij.

13. Qeveria paraqiti të njëjtat argumente si ato në çështjen *Meli and Swinkels Family Brewers N.V.* (cituar më lart), duke argumentuar në thelb që pas ndryshimeve të vitit 2016 (shihni paragrafin 8 më lart) Gjykata Kushtetuese, duke vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kishte garantuar të drejtën për një gjykim të drejtë.

14. Gjykata vëren se kjo çështje nuk dallon në këtë drejtim nga ajo e *Meli dhe Swinkles Family Brewers N.V.* (cituar më lart, § 76), ku gjeti se fakti që kërkuesve nuk i ishin dhënë shkaqet përkatëse për rrëzimin e pretendimeve të tyre përbënte shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës. Në atë çështje, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me ankimin e kërkuesve ishte i kufizuar edhe në vënien në dukje të rezultatit të votimit dhe të rezultatit të tij, por nuk u dhanë arsye për themelin e çështjes (shihni paragrafin 7 më lart). Gjykata vlerësoi se kërkuesit në atë çështje kishin mbetur pa arsyetimin e duhur në lidhje me shkaqet mbi të cilat Gjykata Kushtetuese kishte dalë në konkluzionet e saj.

15. Në lidhje me çështjen në fjalë, pas shqyrtimit të të gjithë materialit para saj, Gjykata vlerëson se qeveria nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo argument që ta bindte për të dalë në një konkluzion të ndryshëm. Prandaj, Gjykata del në përfundimin se kjo mungesë e arsyetimit adekuat nuk plotësoi kërkesat për proces gjyqësor të drejtë. Prandaj në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E PARAGRAFIT 1, TË NENIT 6 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN E AKSESIT NË GJYKATËN KUSHTETUESE

16. Parimet përkatëse mbi të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate dhe, në veçanti, për aksesin në gjykatat më të larta janë përmbledhur në *Zubac kundër Kroacisë* ([DHM], nr. 40160/12, §§ 76–99, 5 prill 2018. Gjykata ka adresuar situatën specifike të shumicës së cilësuar të votave nga Gjykata Kushtetuese në Shqipëri në *Meli dhe Swinkels Family Brewers N. V.* (cituar më lart, §§ 64–66).

17. Kërkuesi pretendoi se Gjykata Kushtetuese duke rrëzuar çështjen e tij nuk i dha një vendim përfundimtar dhe shkeli të drejtën e tij për akses në gjykatë.

18. Në *Meli dhe Swinkles Family Brewers N. V.* (cituar më lart, §67) ankimet kushtetuese të kërkuesve u rrëzuan përfundimisht sepse anëtarët e trupit gjykues nuk mund të arrinin shumicën me pesë gjyqtarë të kërkuar me ligj. Gjykata doli në përfundimin që kërkuesve nuk u ishte privuar e drejta për të vendosur për themelin e ankimeve të tyre, sepse rrëzimi nga Gjykata Kushtetuese ishte përfundimtar dhe u mor pas diskutimeve të duhura për themelin e ankimeve. Prandaj, nuk kishte shkelje të të drejtës për akses në gjykatë sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

19. Meqë të dyja çështjet kanë të bëjnë me të njëjtin problem, Gjykata nuk sheh arsye për t'u shmangur nga gjetjet e saj të mëparshme. Në këtë çështje, ankimi kushtetues i kërkuesit u rrëzua me trup gjykues me gjashtë gjyqtarë të ndarë katër me dy kundër gjetjes së shkeljes kushtetuese (shihni paragrafin 7 më lart). Kërkuesi u informua për rezultatin e votimit dhe pasojat e këtij rezultati për ankimet e tij. Prandaj, atij nuk ju privua e drejta për vendim mbi themelin e ankimeve të tij.

20. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me paragrafin 3 (a) dhe 4, të nenit 35 të Konventës.

III. ANKIME TË TJERA

21. Gjithashtu, kërkuesi u ankua sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, për mungesën e arsyetimit të duhur të Gjykatës së Lartë, që Gjykata e Lartë nuk ishte e pavarur dhe e paanshme, dhe sipas paragrafit 2, të nenit 6 për prezumimin e pafajësisë.

22. Duke pasur parasysh gjetjen e saj, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një vendim gjyqësor të arsyetuar sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës (shihni paragrafin 16 më lart), Gjykata thekson se tani kërkuesi ka mundësi të kërkojë rihapjen e proceseve përpara Gjykatës Kushtetuese (shihni paragrafin 25 më poshtë). Në parim kjo mundëson shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuesit sipas Konventës përmes një vendimi të arsyetuar si duhet të asaj gjykate. Në këto rrethana dhe në përputhje me rolin e saj plotësues, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankimet e mbetura të kërkuesit në këtë moment. Për atë është e hapur mundësia që të depozitojë kërkesa të reja në Gjykatë, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimin e tij kushtetues në nivel kombëtar.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

23. Kërkuesi kërkoi 50,000 euro (EUR) për dëmin jomonetar dhe 10,000 EUR për kosto dhe shpenzime të kryera pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës.

24. Qeveria gjykon që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara, dhe më tej deklaron që kërkuesi nuk kishte paraqitur fatura të mjaftueshme për të provuar shpenzimet e tij.

25. Gjykata përsërit që një vendim gjyqësor ku ajo gjen shkelje të Konventës vendos ndaj shtetit të

paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të korrigjuar pasojat e saj. Nisur nga natyra e ankimit të kërkuesve dhe e shkeljes së gjetur, Gjykata vlerëson se forma më e përshtatshme e korrigjimit në këtë çështje do të ishte rihapja e procesit përpara Gjykatës Kushtetuese, nëse e kërkon kërkuesi, nisur nga fakti që është në gjendje të sigurojë *restitutio in integrum,* siç e kërkon neni 41 i Konventës (krahasoni *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77–79, 10 maj 2011, dhe *X kundër Holandës*, nr. 72631/17, § 61, 27 korrik 2021). Në këtë drejtim, Gjykata vëren që neni 71(c) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon që proceset në Gjykatën Kushtetuese mund të rihapen nëse një gjykatë ndërkombëtare, juridiksioni i të cilës shtrihet në Republikën e Shqipërisë, konstaton se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi "për shkak të një vendimi [të mëparshëm] të Gjykatës Kushtetuese". Thënë kjo, konstatimi i një shkeljeje përbën shpërblim mjaftueshëm të drejtë në këtë çështje.

26. Në lidhje me kostot dhe shpenzimet për proceset gjyqësore përpara Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës, kërkuesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij me dokumente mbështetëse përkatëse. Prandaj Gjykata e refuzon pretendimin.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. shpall të pranueshëm ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën për vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe të papranueshëm ankimin sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës për aksesin në Gjykatën Kushtetuese;

2. gjen shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me të drejtën e kërkuesit për vendim të arsyetuar nga Gjykata Kushtetuese;

3. shprehet që gjetja e shkeljes përbën në vetvete shpërblim mjaftueshëm të drejtë për çdo dëm jomonetar të pësuar nga kërkuesi;

4. vendos që nuk ka nevojë të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e ankimeve të mbetura;

5. rrëzon pretendimin e kërkuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 shkurt 2025, sipas rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELARE

Lətif Hüseynov
KRYETAR

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 81066/17

KE HIDROPROJEKT SHPK kundër Shqipërisë dhe 3 kërkesa të tjera
(shihni tabelën bashkëngjitur**)**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 21 nëntor 2024, si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir*, Kryetar*, Úna Ní Raifeartaigh, Mateja Đurović*, gjyqtarë*, dhe Viktoriya Maradudina, *Zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme të depozituara në datat e ndryshme të treguara në tabelën bashkëngjitur,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Lista e kërkuesve jepet në shtojcë.

Ankimet e kërkuesve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës për kufizimet mbi të drejtën e tyre për akses në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë, si edhe një ankim sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 në lidhje me ndërhyrjen në të drejtat e pronës mbi një parcelë toke ju komunikuan qeverisë shqiptare, e cila paraqiti parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin.

Kërkuesve iu kërkua të paraqesin prapësimet e tyre, si edhe pretendimet e tyre për shpërblim të drejtë. Përpjekjet e përsëritura të Sekretarisë për të kontaktuar kërkuesit nuk ishin të suksesshme. Kërkuesit nuk u përgjigjën.

Vëmendja e kërkuesve u tërhoq nga neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se

kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen. Nuk pati asnjë përgjigje.

LEGJISLACIONI

Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e sheh të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata del në përfundimin që mund të konsiderohet se kërkuesit nuk dëshirojnë më të ndjekin kërkesat e tyre (neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në përputhje me nenin 37 paragrafi 1 (a) *in fine*, Gjykata nuk gjen rrethana të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohen në Konventë dhe në protokollet e saj që kërkojnë vazhdimin e shqyrtimin të kërkesave.

Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

vendos të bashkojë kërkesat;

vendos të heqë kërkesat nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 dhjetor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

Oddný Mjöll Arnardóttir
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e kërkesave

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes/regjistrimit	Përfaqësuar nga
1	81066/17 24.11.2017	**KE HIDROPROJEKT SHPK** 1998	Aldo Shala
2	25006/18 20.5.2018	**Fatmir KOÇI** 1960	
3	37314/18 1.8.2018	**Shpëtim SPAHIU** 1957	
4	56523/18 20.11.2018	**Xhaferr SHTËPANI** 1944	Agron Lamaj

KËRKESË
Nr. 22/8, datë 24.2.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rritja e sigurisë së digës dhe përmirësimi i aftësive ujëmbledhëse të rezervuarit të Kurjanit"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Roskovec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur sipas: VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" (çmim reference është marrë ZK në kufi me ZK 3196, për zërin kadastral "arë", në mungesë të vlerës së tokës arë për ZK 3196) dhe VKM-së nr. 138 datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Roskovec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **2,481,500 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE EMËRORE E PRONARËVE, QË SHPRONËSOHEN, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RRITJA E SIGURISË SË DIGËS DHE PËRMIRËSIMI I AFTËSISË UJËMBLEDHËSE TË REZERVUARIT TË KURJANIT", ROSKOVEC

NR.	PRONARI												VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM										SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
													"ARË"			"TRUALL"			"NDËRTESË"			Vlerat e kultura bujqësore		VLERA TOTALE (lekë)	
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e drufrutoreve (lekë)		
1	Ilir	Shahin	Gega	3196	355/41	arë	4000				13	152	4000	269	1076000							342000		1418000	
2	Sali	Ramadan	Gega	3196	355/42	arë	3000				13	153	3000	269	807000							256500		1063500	
3	Shtet			3196	355/21	shesh	5070						1000											0	
	SHUMA PARAPRAKE														**1883000**							**598500**		**2481500**	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/02/28 14:11:18 +02'00'
4706e1e98f9441deb552e18ff3b8574d2025022814
110696031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)